



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 384 Prot.

Tiranë, më 12.01.2020

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1555, datë 22.02.2012.

SHOQËRISË “BERALB” SH.A
Rruga Papa Gjon Pali II, ABA Bisnes Centër, Kati 13, Tiranë

Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “BERALB” sh.a, e cila është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1555, datë 22.02.2012, për mineralin bakër në objektin “Karma 2”, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.4491, datë 09.12.2020, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.8597, Prot, datë 10.12.2020, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1555, datë 22.02.2012, për mineralin bakër, në objektin “Karma 2”, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër, sepse shoqëria nuk zhvillon aktivitet minierar më shume se një vit në objekt.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minierar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit Nr.1555, datë 22.02.2012, për mineralin bakër, në objektin “Karma 2”, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit **Nr.1555, datë 22.02.2012, për mineralin bakër, në objektin “Karma 2”, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër.**

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

